



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 2 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i

vendimit në lidhje me rishikimin e paraburgimit të Kadri Veselit

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 41(10) dhe (12) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 nëntor 2020, në vijim të konfirmimit të aktakuzës (“Vendimi i Konfirmimit”),² Kadri Veseli (“z. Veseli”) u arrestua në përputhje me vendimin dhe fletarrestimin e lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.³
2. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e z. Veseli për lirim të përkohshëm (“vendimi i parë për paraburgimin”).⁴
3. Më 24 shkurt 2021, në vijim të kërkesës së përbashkët të të akuzuarve në çështjen gjyqësore aktuale, të cilët gjithashtu hoqën dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit para përfundimit të afatit dymujor të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ndryshoi afatin për paraqitjen e parashtrimeve nga z. Veseli lidhur me vazhdimin e paraburgimit deri në dhjetë ditë pas njoftimit të vendimit të panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelimin e tij kundër vendimit të parë për paraburgimin.⁵

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, publik; F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza e redaktuar më tej*, 4 nëntor 2020, publike.

³ KSC-BC-2020-06, F00050, Administratorja, *Njoftim i arrestimit të Kadri Veselit sipas rregullës 55(4)*, 5 nëntor 2020, publik; F00027/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i redaktuar publik i vendimit mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi*, 26 tetor 2020, publik; F00027/A03/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit për Kadri Veselin*, 26 tetor 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00178, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kërkesën e Kadri Veselit për lirim të përkohshëm*, 22 janar 2021, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00206, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kërkesën e përbashkët të mbrojtjes për zgjatjen e afatit*, 24 shkurt 2021, publik, para. 3, 5, 6.

4. Më 30 prill 2021, paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelin e z. Veseli kundër vendimit të parë për paraburgimin ("vendimi i Gjykatës së Apelit").⁶
5. Më 7 maj 2021, z. Veseli e njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake se, pa cenuar të drejtën për paraqitur kërkesa për lirim të përkohshëm në të ardhmen, ai nuk mendonte të bënte parashtrime në lidhje me vazhdimin e paraburgimit.⁷
6. Më 19 maj 2021, pasi z. Veseli e shqyrtoi edhe një herë pozitën e vet dhe bëri të ditur se ishte e përshtatshme të bënte parashtrime në lidhje me vazhdimin e paraburgimit,⁸ Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ndryshoi afatin deri më 31 maj 2021.⁹
7. Më 1 qershor 2021, pas kërkesës nga z. Veseli, i cili hoqi dorë edhe një herë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit para përfundimit të afatit dymujsh të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përsëri e ndryshoi afatin deri më 4 qershor 2021, si dhe ndryshoi numrin e lejuar të fjalëve për këto parashtrime në 7,500 fjalë.¹⁰
8. Më 7 qershor 2021, z. Veseli dorëzoi parashtrimet në lidhje me vazhdimin e paraburgimit të tij dhe kërkoi që të lirohet me kushte të caktuara ("kërkesa").¹¹ Zyra e

⁶ KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Paneli i Dhomës së Apelit, *Vendim mbi apelin e Kadri Veselit kundër vendimit për lirim të përkohshëm*, 30 prill 2021, publik.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00283, Mbrojtja e z. Veseli, *Njoftim i mbrojtjes së Veselit në përputhje me vendimin KSC-BC-2020-06-F00206*, 7 maj 2021, publik, para. 4.

⁸ KSC-BC-2020-06, Transkripti, 19 maj 2021, publik ("Transkripti i 19 majit 2021"), f. 442, rreshtat 2-13.

⁹ Transkripti i 19 majit 2021, f. 451, rreshti 19 – f. 452, rreshti 2.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00334, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim në lidhje me kërkesat e Veselit për zgjatjen e afatit dhe tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve*, 1 qershor 2021, publik, para. 2, 3, 10, 11, 13.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00341, Mbrojtja e z. Veseli, *Parashtrimet e mbrojtjes së Veselit në lidhje me rishikimin e paraburgimit, me shtojcat konfidenciale A deri C*, 7 qershor 2021, konfidenciale, para. 38, me Shtojcat A-C, konfidenciale. Ndonëse kërkesa u dorëzua pas përfundimit të afatit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në përputhje me rregullën 9(5)(b) të Rregullores, bën përjashtim dhe e njuh kërkesën si të vlefshme për shkak të rëndësisë së rishikimit të paraburgimit të z. Veseli. Versioni i redaktuar publik i kërkesës u dorëzua më 25 qershor 2021, F00341/RED.

Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) u përgjigj më 17 qershor 2021 (“përgjigja”).¹² Z. Veseli u kundërpërgjigj më 22 qershor 2021 (“kundërpërgjigja”).¹³

II. PARASHTRIME

9. Z. Veseli kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që të urdhërojë lirimin e tij mbi bazën se paraburgimi i tij nuk është më i përligjur dhe se qëllimi parandalues i tij mund të arrihet në të njëjtën masë duke urdhëruar arrest shtëpiak të mbikëqyrur dhe përmes masave të rrepta dhe të rënda të renditura në kërkesë.¹⁴

10. ZPS-ja përgjigjet se vazhdimi i paraburgimit të z. Veseli vazhdon të jetë i domosdoshëm sepse nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm të rrethanave që t'i bëjë më pak të rëndësishme arsyet e përcaktuara për paraburgim, dhe se rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit në fakt janë shtuar që nga vendimi i parë për paraburgimin.¹⁵

11. Në kundërpërgjigjen e vet, z. Veseli përsërit kërkesën drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake për lirimin e tij me ose pa kushtet e propozuara më herët.¹⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Neni 41(6) i Ligjit parasheh që Dhomat e Specializuara (“DHS”) urdhërojnë paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprë penale brenda juridiksionit të DHS-së dhe ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) përbën rrezik për arratisje; (ii) do të asgjësojë, fshehë,

¹² KSC-BC-2020-06, F00354, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj parashtrimeve të mbrojtjes së Veselit në lidhje me rishikimin e paraburgimit me shtojcën konfidenciale 1*, 17 qershor 2021, konfidenciale, me shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua të njëjtën ditë, F00354/RED.

¹³ KSC-BC-2020-06, F00365, Mbrojtja e z. Veseli, *Kundërpërgjigje e mbrojtjes së Veselit ndaj përgjigjes së ZPS-së – KSC-BC-2020-06/F00354 (Rishikimi i paraburgimit)*, 22 qershor 2021, konfidenciale, me shtojcën 1, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 24 qershor 2021, F00365/RED.

¹⁴ Kërkesa, para. 2, 38.

¹⁵ Përgjigja, para. 1.

¹⁶ Kundërpërgjigja, f. 7.

ndryshojë ose falsifikojë prova të veprës penale ose rrethana të caktuara tregojnë se personi do të pengojë ecurinë e procedurës penale; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë vepër penale në tentativë, ose do të kryejë ndonjë vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

13. Neni 41(10) i Ligjit parasheh që, deri në kohën kur aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirim nga paraburgimi, pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit për mbajtje në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose trupi gjykues i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendimin për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit. Kjo parashikohet edhe në rregullën 57(2) të Rregullores.

14. Neni 41(12) i Ligjit përcakton se krahas mbajtjes në paraburgim, mund të urdhërohen edhe masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të siguruar kryerjen e suksesshme të procedimit penal: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve ose personave të caktuar, paraqitja në një stacion policie apo vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

15. Në përputhje me rregullën 56(2) të Rregullores, paneli siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes dhe, në rast të vonesës së paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, paneli, pas dëgjimit të palëve, mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

16. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të nenit 41(10) të Ligjit, ai ka detyrimin të shqyrtojë nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim, përfshirë arsyet e përcaktuara në nenin 41(6), konkretisht nëse (i) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer veprën/veprat penale dhe (ii) ka arsye të artikulueshme për

të besuar se ekziston ndonjë nga rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.¹⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka detyrimin të bëjë konstatime në lidhje me faktorët që tashmë janë vendosur në vendimin e parë për paraburgimin, por duhet t'i shqyrtojë këto arsye dhe rrethana dhe të përcaktojë se a ekzistojnë ende. Thelbësore është që në kohën e rishikimit të vendimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bindet se ende ekzistojnë arsyet për vazhdimin e paraburgimit.¹⁸ ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.¹⁹

A. DYSHIMI I BAZUAR

17. Sa i përket standardit lidhur me vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit së pari kërkon ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së. Ky është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimin të paraburgimit të të paraburgosurit.²⁰

18. Sa i përket përfshirjes së drejtpërdrejtë të tij në kryerjen e krimeve, z. Veseli parashtron se nuk ekzistojnë prova të tilla që të mund të përlligjin vazhdimin e paraburgimit të tij.²¹ Së pari, z. Veseli parashtron se pretendimet që ai ka qenë i pranishëm në [REDAKTUAR] bazohen vetëm në dëshminë e një dëshmitari, por ky dëshmitar nuk e kishte fjalën për z. Veseli.²² E dyta, sipas z. Veseli, provat për rolin e tij në transferimin e pretenduar në [REDAKTUAR] të [REDAKTUAR], janë shfajësuese, sepse dëshmitari në fjalë ka deklaruar se z. Veseli kishte kërkuar që

¹⁷ *Shih për shembull* KSC-BC-2020-07, F00143, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi rishikimin e paraburgimit të Hysni Gucatit*, 24 shkurt 2021, publik, para. 17.

¹⁸ KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi apelin e Nasim Haradinajt kundër vendimit për rishikimin e paraburgimit*, 9 shkurt 2021, para. 55.

¹⁹ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 20, me referenca shtesë. *Në mënyrë të ngjashme*, ECtHR/GJEDNJ, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#) ("*Merabishvili v. Georgia* [GC]"), 28 nëntor 2017, para. 234.

²⁰ [Merabishvili v. Georgia](#) [GC], para. 222, me referenca shtesë.

²¹ Kërkesa, para. 6.

²² Kërkesa, para. 10-16.

[REDAKTUAR] të trajtohej mirë.²³ Së fundi, z. Veseli argumenton se provat në lidhje me pjesëmarrjen e pretenduar të tij në krimet e kryera në [REDAKTUAR] nuk duhet të merren parasysh sepse ato prova ose nuk janë nxjerrë, ose janë nxjerrë në formë të redaktuar.²⁴

19. Z. Veseli më tutje parashtron se pretendimet për ndërmarrje kriminale të përbashkët ("NKP") dhe përgjegjësi komanduese janë të mjegullta dhe nuk ka prova që i mbështesin ato në mënyrë të drejtpërdrejtë.²⁵ Z. Veseli shton se këto pretendime janë objekt i kundërshtimit të juridiksionit dhe se zgjidhja përfundimtare e këtij kundërshtimi prej Dhomës së Specializuar e Gjykatës Kushtetuese është parakusht për kryerjen e efektshme të hetimeve të mbrojtjes dhe për fillimin e çfarëdo gjykimi.²⁶

20. ZPS-ja kundërpërgjigjet se neni 41(6)(a) i Ligjit kërkon vetëm ekzistencën e dyshimit të bazuar se janë kryer krimet e paraqitura në aktakuzë; Gjykatësi i Procedurës Paraprake tashmë ka konstatuar se ekziston dyshim i bazuar mirë që z. Veseli i ka kryer krimet për të cilat është akuzuar dhe asgjë nuk ka ndryshuar për të për ligjur rishqyrtimin e këtij vendimi.²⁷ Sipas ZPS-së, argumentet e paraqitura nga z. Veseli janë çështje standarde që kanë të bëjnë me provat, dhe duhet të debatohen e për to duhet të vendoset gjatë gjyqimit.²⁸ ZPS-ja shton se z. Veseli nuk është akuzuar se ka kryer krime si kryes i drejtpërdrejtë, por se, ndër format e tjera të përgjegjësisë, se përmes pozitive të tij drejtuese ka marrë dhe ushtruar kontroll mbi tërë Kosovën me mjete kriminale, përfshirë duke përdorur anëtarë jashtë planit të përbashkët për kryerjen e krimeve kundër personave të konsideruar si kundërshtarë.²⁹ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se i kundërshton fuqimisht mocionet paraprake të z. Veseli, se ato duhet të zgjidhen jashtë fushëveprimit të këtij shqyrtimi dhe, në çdo rast, nuk ndikojnë

²³ Kërkesa, para. 17-19.

²⁴ Kërkesa, para. 20-25.

²⁵ Kërkesa, para. 6, 26.

²⁶ Kërkesa, para. 26.

²⁷ Përgjigja, para. 10.

²⁸ Përgjigja, para. 10.

²⁹ Përgjigja, para. 11.

në vlerësimin e rrezikut sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.³⁰ ZPS-ja gjithashtu parashtron se nuk ka tregues që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të jetë bazuar në prova të redaktuara në lidhje me [REDAKTUAR] dhe se provat në fjalë janë objekt i nxjerrjes së vonuar dhe masave të tjera mbrojtëse.³¹

21. Z. Veseli përgjigjet se ZPS-ja e pranon se ai nuk është “kryes i drejtpërdrejtë”.³² Ai shton se, që nga vendimi i parë për paraburgimin, nuk është cituar as edhe një provë materiale në materialin e nxjerrë sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores në mbështetje të të ashtuquajturave “dëshmi në rritje” të kriminalitetit të pretenduar të z. Veseli.³³ Për më tepër, sipas mendimit të z. Veseli, incidentet që lidhen me të ndaluar të veçantë u ofruan nga ZPS-ja dhe u pranuan nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake si faktor kyç i përbashkët i elementit subjektiv në të katër format e përgjegjesisë të paraqitura në aktakuzë.³⁴ Z. Veseli gjithashtu pretendon se: (i) duke mos e përmendur incidentin në [REDAKTUAR], duket se ZPS-ja ka pranuar në heshtje asgjësimin e plotë prej Mbrojtjes të pretendimit për pjesëmarrjen e tij [REDAKTUAR];³⁵ (ii) ZPS-ja duket se pajtohet se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mund të bazohet në prova të redaktuara lidhur me [REDAKTUAR];³⁶ dhe (iii) sa i përket ngjarjeve në [REDAKTUAR], ZPS-ja nuk e kundërshton [REDAKTUAR].³⁷ Sipas z. Veseli, pamundësia e ZPS-së për t'i vërtetuar këto pretendime është rrethanë që ka ndryshuar.³⁸

22. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Konfirmimit u përcaktua se, në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar se z. Veseli është penalisht përgjegjës për një numër krimesh kundër njerëzimit (përndjekje,

³⁰ Përgjigjja, para. 12.

³¹ Përgjigjja, para. 13.

³² Kundërpërgjigjja, para. 1.

³³ Kundërpërgjigjja, para. 3.

³⁴ Kundërpërgjigjja, para. 4.

³⁵ Kundërpërgjigjja, para. 5.

³⁶ Kundërpërgjigjja, para. 5.

³⁷ Kundërpërgjigjja, para. 5-6.

³⁸ Kundërpërgjigjja, para. 7.

burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje dhe zhdukje me forcë) dhe për krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje) sipas neneve 13, 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit.³⁹ Standardi mbi të cilin u bazuan këto konstatime ishte më i lartë se sa ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas të nenit 41(6)(a) të Ligjit.⁴⁰

23. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se z. Veseli argumenton që çështja kundër tij përbëhet nga dy pjesë; konkretisht, prova të drejtpërdrejta lidhur me pretendimin se ai mori pjesë personalisht në sjellje penale, dhe pretendimet e mjegullta për NKP-në dhe përgjegjësinë eprore, për të cilat nuk ka prova të drejtpërdrejta për t'i mbështetur.⁴¹ Kështu, z. Veseli bën dallimin midis formave të përgjegjesisë të kryerjes së drejtpërdrejtë nga njëra anë, dhe NKP-së dhe përgjegjesisë eprore në anën tjetër. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se z. Veseli nuk është akuzuar si kryes i drejtpërdrejtë i asnjë prej krimeve të renditura në Vendimin e Konfirmimit, por në bazë të formave të përgjegjesisë në vijim: NKP I, NKP III, ndihmë dhe inkurajim, dhe përgjegjësi eprore.⁴² Rrjedhimisht, argumentet e z. Veseli lidhur me pretendimin për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të tij në kryerjen e krimeve duhet të vlerësohen kundrejt këtyre formave të përgjegjesisë.

24. Çka është më thelbësore dhe siç pranohet pjesërisht nga z. Veseli në kundërpërgjigje,⁴³ konstatimet në Vendimin e Konfirmimit për ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë që z. Veseli ka marrë pjesë drejtpërdrejt në kryerjen e krimeve, ishte vetëm një faktor në mesin e një numri faktorësh të tjerë të përmendur përkitazi kriterëve të ndryshme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale individuale të z. Veseli për krime të ndryshme kundër njerëzimit dhe krime lufte. Kështu, argumentimi

³⁹ Vendimi i Konfirmimit, para. 521(a).

⁴⁰ *Shih për shembull* KSC-BC-2020-04, F00007/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i redaktuar publik i vendimit mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, publik, para. 35.

⁴¹ Kërkesa, para. 6.

⁴² Vendimi i Konfirmimit, para. 451-454, 460-463, 473, 475-482, 492-498.

⁴³ Kundërpërgjigja, para. 7; KSC-BC-2020-06, F00365, Mbrojtja e z. Veseli, *Shtojca 1 e kundërpërgjigjes së mbrojtjes së Veselit ndaj përgjigjes së ZPS-së – KSC-BC-2020-06/F00354 (Rishikimi i paraburgimit)*, 22 qershor 2021, konfidenciale.

përzgjedhës i z. Veseli lidhur me pjesëmarrjen e pretenduar të tij në kryerjen e krimeve duhet të vlerësohet në kontekstin e Vendimit të Konfirmimit në tërësi.

25. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se z. Veseli i referohet paragrafit 447 të Vendimit të Konfirmimit për të mbështetur parashtrimet në kërkesën e tij.⁴⁴ Ky paragraf ka të bëjë me konstatimin kontekstual se pretendohet që kryesit ish-in në dijeni për sulmin kundër popullatës civile, në lidhje me akuzat për krime kundër njerëzimit. Por ky konstatim nuk u bazua vetëm në pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të supozuar të z. Veseli në krime, apo praninë e tij në vendet e krimeve. Ai u mbështet veçanërisht edhe në faktet se: (i) pretendohet se ish-in krijuar struktura policore dhe të zbulimit nga udhëheqja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"), pjesë e së cilës ishte z. Veseli, për identifikimin dhe hetimin e individëve që konsideroheshin kundërshtarë; (ii) të akuzuarit në çështjen aktuale, ndër të cilët z. Veseli, pretendohet se kishin dijeni për praktikën e dhunës në vijimësi, dhe (iii) pretendohet se udhëheqja e UÇK-së kishte lëshuar deklaratë publike, rregullore, direktiva dhe urdhra që nxisnin sulmet kundër individëve të perceptuar si kundërshtarë.⁴⁵

26. Kjo është e vërtetë edhe në lidhje me kontributin e konsiderueshëm të pretenduar të z. Veseli në qëllimin të përbashkët dhe synimin kriminal të tij sa i përket NKP I. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka përcaktuar se, përveç pjesëmarrjes së tij të drejtpërdrejtë në krime ose pranisë në vendet e krimit, z. Veseli: (i) pretendohet se ka qenë i përfshirë në formulimin, miratimin, shpërndarjen dhe zbatimin e planeve, politikave dhe praktikave për arritjen e qëllimit të përbashkët; dhe (ii) pretendohet se ka siguruar informacion dhe mbështetje politike, logjistike, ushtarake ose financiare, si dhe bashkërendoi dhe mbajti lidhje midis anëtarëve të NKP-së për arritjen e qëllimit të përbashkët.⁴⁶ Po kështu, janë përmendur edhe faktorë të tjerë përveç pjesëmarrjes

⁴⁴ Kërkesa, poshtëshënimi 4.

⁴⁵ Vendimi i Konfirmimit, para. 447.

⁴⁶ Vendimi i Konfirmimit, para. 460, 461, 463, 473.

së drejtpërdrejtë të pretenduar të z. Veseli në krime ose pranisë së tij në vendet e krimeve, lidhur me elementet objektive dhe/ose subjektive në kuadër të NKP III,⁴⁷ ndihmës dhe inkurajimit,⁴⁸ dhe përgjegjesisë eprore.⁴⁹

27. Si rezultat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është e nevojshme t'u përgjigjet argumenteve konkrete të z. Veseli lidhur me provat e përzgjedhura që mbështesin konstatimet se ai mori pjesë drejtpërdrejt në kryerjen e krimeve në rastet e lartpërmendura. Pa paragjykuar meritat e këtyre argumenteve, të cilat mund t'i paraqiten trupit gjykues, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se mungesa e provave në lidhje me këtë pjesëmarrje të pretenduar nuk cenon konstatimin se ekziston dyshimi i bazuar mirë që z. Veseli mban përgjegjësi penale individuale, sipas formave të ndryshme të përgjegjesisë për një numër krimesh kundër njerëzimit dhe krime lufte. Arsyeja është se, siç u demonstrua më lart, ai konstatim u bazua në disa faktorë shtesë. Nga kjo rrjedh se nga ana e tyre, as parashtrimet përzgjedhëse të z. Veseli nuk mund të ndikojnë në nxjerrjen e përfundimit të përgjithshëm se, sipas nenit 41(6)(a) dhe (10) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar që z. Veseli ka kryer krime brenda juridiksionit lëndor të DHS-së. Gjithashtu kjo nënkupton se, në kundërshtim me pretendimet e z. Veseli,⁵⁰ nuk është me rëndësi nëse ZPS-ja ka paraqitur ose jo prova shtesë në mbështetje të pretendimeve për përfshirjen personalisht të z. Veseli në kryerjen e krimeve gjatë nxjerrjeve të tjera pas vendimit të parë për paraburgimin.

28. Për më tepër, është i pabazë parashtrimi shtesë i z. Veseli se pretendimet kundër tij për NKP dhe përgjegjësi eprore janë të mjegullta⁵¹; si i tillë, ai nuk vë në dyshim, siç u shtjellua më lart, faktin që ekziston dyshim i bazuar se ai mban përgjegjësi penale individuale, përfshirë edhe në kuadër të këtyre dy formave të përgjegjesisë. Së fundi, fakti që, siç argumenton z. Veseli,⁵² këto forma të përgjegjesisë janë objekt i

⁴⁷ Vendimi i Konfirmimit, para. 477.

⁴⁸ Vendimi i Konfirmimit, para. 480-481.

⁴⁹ Vendimi i Konfirmimit, para. 496.

⁵⁰ Kundërpërgjigjja, para. 7.

⁵¹ Kërkesa, para. 26.

⁵² Kërkesa, para. 26.

kundërshtimit të juridiksionit është juridikisht jothelbësor për qëllimet e këtij vendimi, për arsye se këto kundërshtime janë në proces shqyrtimi dhe nuk mund të ndikojnë në vlerësimin nëse aktualisht vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Veseli ka kryer krime brenda juridiksionit lëndor të DHS-së. Sa i përket argumentit të z. Veseli se zgjidhja përfundimtare e këtyre kundërshtimeve do të shkaktojë zgjatjen e paraburgimit të tij në pritje të gjyqimit, vlerësimi se vendimi i Gjykatës të Procedurës Paraprake dhe debatet e mëtejshme juridike do të kenë ndikim të tillë është hamendësues.⁵³

29. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Veseli ka kryer krime brenda juridiksionit lëndor të DHS-së sipas nenit 41(6)(a) dhe (10) të Ligjit.

B. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

30. Pasi përmbushjes së standardit sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që përlligjin heqjen e lirisë së personit duhet të jenë të artikulueshme, në kuptimin që duhet të jenë të specifikohen me hollësi.⁵⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se, bazuar në provat e disponueshme, arsyet konkrete të artikulueshme duhet të mbështesin “besimin”⁵⁵ se ekziston ndonjë prej rreziqeve të parapara në secilin prej nënparagrafëve të nenit 41(6)(b) të Ligjit, çka nënkupton pranimin e mundësisë, e jo të pashmangshmërisë, se ato mund të ndodhin në të ardhmen.⁵⁶ Me fjalë të tjera, standardi që duhet të zbatohet është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.⁵⁷ Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës

⁵³ *Shih gjithashtu* para. 55-56 më poshtë.

⁵⁴ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 21; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 18-19.

⁵⁵ *Shih* përgjithësisht nenit 41(6)(b) të Ligjit.

⁵⁶ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 21, me referenca shtesë.

⁵⁷ Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 17.

Paraprake duhet të shqyrtojë masat alternative për parandalimin e rreziqeve të parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.⁵⁸

1. Rreziku i arratisjes

31. Në kërkesën e tij z. Veseli nuk ka bërë parashtrime në lidhje me rrezikun e arratisjes. Në përgjigjen e saj, ZPS-ja parashtron se z. Veseli po njihet gjithnjë e më shumë me provat kundër tij, çka vetëm e shton motivimin dhe mundësinë që ai të përpiket t'u ikë procedurave gjyqësore.⁵⁹ ZPS-ja gjithashtu përmend pozitën me ndikim dhe autoritet të z. Veseli mbi vartësit e dikurshëm dhe mbështetësit, dhe parashtron se ky rrjet i mundshëm është po aq aktiv sa edhe më parë.⁶⁰ Në lidhje me këtë, ZPS-ja përmend fushatën në mbështetje të UÇK-së që u organizua pak kohë pas arrestimit të z. Veseli dhe deklaratën e kohëve të fundit të kryetarit në detyrë të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së se në qoftë se do të merrte dokumente të tjera konfidenciale, do t'i bënte ato bënte publike.⁶¹ Z. Veseli kundërpërgjigjet se tërësia e provave të nxjerra e bën edhe më të qartë natyrën gjithnjë më të padrejtë të vazhdimit të paraburgimit të tij.⁶² Ai shton se ZPS-ja nuk asnjëherë ka pretenduar se ai ishte i lidhur me "tentimet për pengim" të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së dhe se ZPS-ja nuk ka ofruar asgjë për të vërtetuar se ai e njej, qoftë edhe formalisht, kryetarin në detyrë të saj.⁶³

⁵⁸ Në lidhje me detyrimin për të shqyrtuar "masa alternative", shih KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, 26 prill 2017, publik, para. 114, Shih gjithashtu ECtHR/GJEDNJ, Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 korrik 2016, para. 87, në fund; ECtHR/GJEDNJ, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 maj 2012, para. 140, në fund.

⁵⁹ Përgjigjja, para. 6.

⁶⁰ Përgjigjja, para. 7.

⁶¹ Përgjigjja, para. 7-8.

⁶² Kundërpërgjigjja, para. 1.

⁶³ Kundërpërgjigjja, para. 2.

32. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se, pas vënies në dijeni për akuzat kundër tij dhe mundësinë e dënimit të rëndë në rast se shpallet fajtor,⁶⁴ z. Veseli është njohur gjithnjë e më shumë me provat që mbështesin këto akuza, si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të tyre. Gjithashtu, z. Veseli vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në Kosovë për arsye të pozitive që ka mbajtur më herët, konkretisht si anëtar themelues i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, anëtar i drejtorisë politike të UÇK-së, shef i degës së zbulimit të UÇK-së, shef i Shërbimit Informativ të Kosovës dhe Kryetar i Kuvendit të Kosovës.⁶⁵ Ndikimi që ai ka në sajë të këtyre pozitive – në veçanti nga pozitat e tij që lidhen me shërbimet e zbulimit – mund ta ndihmojnë që t'i shmanget procedurave të DHS-së, për shembull, duke kërkuar ndihmën e simpatizantëve të tij dhe/ose të UÇK-së, duke siguruar qasje në informacione të rëndësishme dhe fonde e mjete për të udhëtuar.

33. Rrjedhimisht, pavarësisht faktorëve kompensues të identifikuar në vendimin e parë për paraburgimin,⁶⁶ rreziku i arratisjes në lidhje me z. Veseli vazhdon të ekzistojë.

2. Rreziku i pengimit të ecures së procedurave të DHS-së

34. Z. Veseli nuk ka bërë parashtrime në kërkesë në lidhje me rrezikun e pengimit të ecures së procedurave të DHS-së. Në përgjigje, ZPS-ja përmend faktorët e identifikuar më lart në lidhje me rrezikun e arratisjes.⁶⁷ Argumentet e paraqitura nga z. Veseli në kundërpërgjigje gjithashtu janë shtjelluar më lart.⁶⁸

35. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se është konstatuar që z. Veseli është në gjendje t'i japë udhëzime një individ që ndërvepron me DHS-në⁶⁹ dhe, duke e bërë këtë, ai ka ndërhyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë në një çështje që ka të bëjë me DHS-

⁶⁴ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 32.

⁶⁵ Vendimi i Konfirmimit, para. 460; Vendimi i parë për paraburgimin, para. 32.

⁶⁶ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 33.

⁶⁷ Përgjigja, para. 6-8; para. 31 më lart.

⁶⁸ Kundërpërgjigja, para. 1-2; para. 31 më lart.

⁶⁹ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 44.

në.⁷⁰ Kjo duhet shqyrtuar së bashku me faktin se, siç u shtjellua më lart, z. Veseli aktualisht është njohur gjithnjë e më shumë me provat në mbështetje të akuzave të rënda kundër tij për arsye të procesit në vijimësi të nxjerrjes së provave, dhe se ai vazhdon të luajë rol të rëndësishëm në Kosovë për shkak të pozitive të tij të mëparshme.⁷¹ Në veçanti, njohuritë, aftësitë dhe kontaktet që ka fituar z. Veseli në pozitat e tij të mëparshme të lidhura me zbulimin do të vazhdonin t'i mundësonin, për shembull, që të ketë qasje në informacion ose të kërkojë mbështetjen e të tjerëve.⁷² Rrjedhimisht, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, rreziku që z. Veseli të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së vazhdon të ekzistojë, nisur nga vlerësimi i gatishmërisë dhe aftësisë që ka treguar ai për të ndërhyrë në çështje që kanë të bëjnë me DHS-në, dijenia në rritje për provat mbështetëse, dhe aftësia që të mbledhë mjetet për të ndërhyrë në procedurat e DHS-së për shkak të rolit të tij të rëndësishëm në vijimësi.

36. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej rikujton se ekziston klima e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjes në proceset penale kundër anëtarëve të UÇK-së,⁷³ siç shihet nga deklaratat e lartpërmendur e kryetarit në detyrë të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së se do të bënte publike dokumente të tjera të DHS-së nëse do t'i vinin.⁷⁴ Edhe pse ky faktor, në vetvete, nuk është përcaktues sa i përket rrezikut të pengimit të ecurisë së procedurave, ai ofron kontekstin në të cilin duhet të shqyrtohen konstatimet e lartpërmendura që kanë të bëjnë posaçërisht me z. Veseli. Gjithashtu, rikujtojmë se nuk është e nevojshme që rreziku i pengimit të materializohet përmes ndërhyrjes personalisht të të akuzuarit në prova, apo përmes

⁷⁰ Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 38.

⁷¹ *Shih* para. 32 më lart.

⁷² Vendimi i parë për paraburgimin, para. 43; Vendimi i Gjykatës së Apelit, pra. 40.

⁷³ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 48; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 40, 48.

⁷⁴ Përgjigja, para. 8.

ushtrimit prej tij të ndikimit ose trysnisë mbi dëshmitarët. Mjafton që i akuzuari të nxisë të tjerët ose të kontribuojë në çfarëdo mënyre në materializimin e atij rreziku.⁷⁵

37. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ende ekziston rreziku që z. Veseli do të pengojë zhvillimin e procedurave të DHS-së.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

38. Në kërkesën e tij, z. Veseli nuk bën parashtrime në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera. Në përgjigjen e saj, ZPS-ja ngre të njëjtat argumente të identifikuara më lart në lidhje me rrezikun e arratisjes.⁷⁶ Argumentet e parashtruara nga z. Veseli në kundërpërgjigje gjithashtu janë paraqitur më lart.⁷⁷

39. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procedurave nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, në rrethanat e çështjes aktuale faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë me rëndësi edhe për vlerësimin e këtij të fundit.⁷⁸ Rikujtojmë gjithashtu se është e mjaftueshme që i akuzuari të nxisë ose ndihmojë të tjerët në kryerjen e krimeve të tilla, ose të kontribuojë në çfarëdo mënyre tjetër në kryerjen e tyre.⁷⁹

40. Duke iu kthyer fakteve nën shqyrtim, përveç atmosferës së frikësimit të dëshmitarëve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh se z. Veseli ka aftësi të ndërhyjë në procedurat e DHS-së dhe se, aktualisht, njohuritë e tij për provat e ZPS-së kundër tij janë shtuar që nga vendimi i parë për paraburgimin, si rezultat i nxjerrjes e vazhdueshme të provave që mbështesin akuzat e rënda kundër tij.⁸⁰ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu mban parasysh faktin që z. Veseli vazhdon të ketë

⁷⁵ KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i redaktuar publik i vendimit mbi apelin e Rexhep Selimit kundër vendimit për lirim të përkohshëm*, 30 prill 2021, para. 59.

⁷⁶ Përgjigja, para. 6-8; para. 31 më lart.

⁷⁷ Kundërpërgjigja, para. 1-2; para. 31 më lart.

⁷⁸ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 52.

⁷⁹ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 25, 52.

⁸⁰ *Shih* para. 32 më lart.

pozitë të rëndësishme në Kosovë veçanërisht si rezultat i pozitave të tij të lidhura me zbulimin,⁸¹ çka i mundëson të sigurojë mjete për të kryer krime të tjera, për shembull, duke kërkuar mbështetjen e simpatizantëve.

41. Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se ekziston rreziku që z. Veseli do të kryejë, sipas cilësdo forme të përgjegjësisë, krime të ngjashme me krimet bazë për të cilat akuzohet, kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, ku përfshihen edhe dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose që pritet të paraqiten para DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli do të kryejë krime të tjera.

4. Përfundim

42. Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Veseli do të arratiset, do të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së ose të kryejë krime të tjera kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje dhe/ose pritet të paraqiten para DHS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vijim do të vlerësojë nëse ndonjë prej kushteve për lirim të tij mund t'u përgjigjen në mënyrën e duhur këtyre rreziqeve.

C. LIRIMI ME KUSHT

43. Sipas z. Veseli, ai e ka demonstruar më së miri besueshmërinë e tij përmes marrëveshjes me ZPS-në për dorëzimin vullnetar, deklaratës me të cilën kërkoi respektimin e DHS-së, si dhe sjelljes shembullore të tij dhe të familjes gjatë vizitës së tij nën arrest në Kosovë.⁸² Z. Veseli propozon një numër kushtesh që përqendrohen

⁸¹ *Shih* para. 32, 35 më lart.

⁸² *Kërkesa*, para. 31-33.

veçanërisht në masat për parandalimin e komunikimeve të ndaluara (“kushtet e propozuara”).⁸³ Sipas z. Veseli, komunikimi i tij me drejtorin e policisë së Kosovës (“drejtori i policisë” dhe “policia”) konfirmon se këto kushte mund të zbatohen.⁸⁴ Z. Veseli gjithashtu parashtron se, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake kërkon shpjegime në lidhje me këtë informacion, mënyra më e përshtatshme është që t’i dërgojë një listë me pyetje drejtorit të policisë.⁸⁵

44. ZPS-ja përgjigjet se vizita nën arrest e z. Veseli ishte një ndryshim i jashtëzakonshëm dhe i përkohshëm i kushteve të paraburgimit për qëllime rreptësisht të kufizuara dhe humanitare, që nuk mund të krahasohen në mënyrë të njëmendtë me lirin e përkohshëm.⁸⁶ Për më tepër, sa i përket kushteve të propozuara, ZPS-ja është e mendimit se arresti shtëpiak i propozuar ka mangësinë e vetvetishme se z. Veseli do të ketë rregullisht mundësi të flasë privatisht me persona që mund hyjnë dhe dalin lirisht nga banesa e tij.⁸⁷ Ajo gjithashtu parashtron se kontrollimi i mjeteve të komunikimit, ose edhe i dokumenteve me shkrim, nuk mund të ndalojë daljen jashtë banesës të përmbajtjes së atyre bisedave të pamonitoruara.⁸⁸ ZPS-ja gjithashtu argumenton se mangësitë e kushteve të propozuara janë veçanërisht të qarta për sa i përket z. Veseli, i cili është një ndër zyrtarët më me përvojë të zbulimit në Kosovë, shef i mëparshëm i shërbimeve të zbulimit të UÇK-së dhe shef i Shërbimit Informativ të Kosovës.⁸⁹ Po kështu, sipas ZPS-së, nëse asnjë kusht nuk mund t’i zvogëlojë rreziqet e identifikuar, atëherë nuk ekziston detyrimi i vlerësimit të gatishmërisë dhe aftësisë së Kosovës për t’i zbatuar kushtet.⁹⁰ ZPS-ja pretendon se, në çdo rast, garancitë më të fundit të drejtorit të policisë nuk i referohen konkretisht kushteve të propozuara dhe

⁸³ Kërkesa, para. 35-36.

⁸⁴ Kërkesa, para. 37.

⁸⁵ Kërkesa, para. 37.

⁸⁶ Përgjigja, para. 15.

⁸⁷ Përgjigja, para. 17.

⁸⁸ Përgjigja, para. 17.

⁸⁹ Përgjigja, para. 18.

⁹⁰ Përgjigja, para. 19.

nuk ofrojnë asgjë më shumë përveç se përsërisin gatishmërinë e përgjithshme për të zbatuar urdhrat gjyqësorë.⁹¹

45. Z. Veseli kundërpërgjigjet se sa i përket dhënies së shembullit konkret për tendencën e tij për të respektuar besimin e dhënë, sjellja e mirë është faktor shumë i rëndësishëm për t'u marrë parasysh në kryerjen e vlerësimit të rrezikut, sikurse është vepruar në proceset në Gjykatën Penale Ndërkombëtare.⁹² Ai shton se kushti i sjelljes së mirë vlen edhe për anëtarët e familjes së tij të ngushtë.⁹³ Për më tepër, z. Veseli parashtron se email-i i drejtorit të policisë ishte përgjigje konkrete ndaj letrës së mbrojtësit të specializuar të z. Veseli, ku ishte përfshirë edhe një listë me kushte.⁹⁴

46. Sa i përket rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se, siç u konstatua në vendimin e parë për paraburgimin, ky rrezik mund të zvogëlohet mjaftueshëm mbi bazën se z. Veseli është zotuar se do të qëndrojë në arrest shtëpiak, do të dorëzojë dokumentet e udhëtimit dhe do të respektojë ndalimin e udhëtimit.⁹⁵

47. Megjithatë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se asnjë nga kushtet e propozuara dhe as kushtet shtesë të shqiptuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do të mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit.

48. Sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, kushtet e propozuara nuk do të parandalojnë bisedat e pamonitoruara midis z. Veseli dhe familjes së tij ose të vizitorëve të miratuar. Kjo nënkupton që, edhe nëse mund të zbatohen propozimet që anëtarët e familjes dhe vizitorët e miratuar të dorëzojnë pajisjet e tyre dhe të pajtohen me monitorimin e mëpasshëm të pajisjeve të tyre, mesazhet mund të përcillen në një numër mënyrash. Për shembull, duke mbajtur parasysh veçanërisht që z. Veseli ka pozitë të rëndësishme dhe aftësi të caktuara për shkak të përvojës së tij në zbulim,

⁹¹ Përgjigja, para. 20.

⁹² Kundërpërgjigja, para. 8.

⁹³ Kundërpërgjigja, para. 9.

⁹⁴ Kundërpërgjigja, para. 10.

⁹⁵ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 58.

ekziston mundësia reale që z. Veseli mund t'i kërkojë dikujt që t'i përcjellë porosinë me gojë ose të përdorë pajisje që i përkasin një personi të tretë për ta bërë këtë. Gjithashtu, përveç çështjes nëse është e mundshme zbatimi në praktikë i kushteve të tjera, si monitorimi i vizitave nga policia, këto kushte nuk e zvogëlojnë mjaftueshmërisht rrezikun, për shkak të mundësisë së përdorimit të gjuhës së koduar ose të mjegullt, të cilën personat që nuk kanë njohuri me procedurat e DHS-së nuk mund ta njohin apo ta parandalojnë lehtë. Nga kjo rrjedh se komunikimet e z. Veseli mund të kufizohen dhe monitorohen në një mënyrë që i zvogëlon mjaftueshmërisht rreziqet e pengimit të procedurave të DHS-së ose të kryerjes së krimeve të tjera vetëm përmes kornizës së monitorimit të komunikimeve në objektin e paraburgimit të DHS-së.

49. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, pavarësisht kërkesës së z. Veseli për të konfirmuar se policia është e gatshme dhe e aftë të zbatojë listën e hollësishme të kushteve,⁹⁶ letra e dërguar nga drejtori i policisë pohon në përgjithësi se policia është e aftë të zbatojë vendimet dhe urdhrat e DHS-së.⁹⁷ Ky përbën një pohim të përgjithshëm, që nuk trajton posaçërisht nëse kushtet e propozuara mund të zbatohen në mënyrë të efektshme dhe, nëse po, cilat janë masat që do të merren. Në kundërshtim me argumentimin e z. Veseli,⁹⁸ nuk mund të thuhet se natyra e përgjithshme e përgjigjes së drejtorit të policisë përbën pajtim për të zbatuar kushtet e propozuara, ndërkohë që kërkesa e hollësishme e z. Veseli meriton një përgjigje konkrete. Fakti që kushtet e propozuara nuk parandalojnë bisedat e pamonitoruara dhe se për to do të duhej miratimi i masave që kërkojnë burime mjaft të mëdha, e bën edhe më të nevojshme dhënien e një përgjigjeje të hollësishme nga drejtori i policisë. Kjo është veçanërisht e vërtetë sa i përket z. Veseli, për shkak të pozitës së tij të

⁹⁶ Kërkesa, para. 36.

⁹⁷ KSC-BC-2020-06, F00341/A03, Mbrojtja e z. Veseli, *Shtojca C e parashtrimeve të mbrojtjes së Veselit në lidhje me rishikimin e paraburgimit me shtojcat konfidenciale A deri C*, 7 qershor 2021, konfidenciale, f. 7.

⁹⁸ Kundërpërgjigja, para. 10.

rëndësishme në Kosovë dhe aftësive të veçanta që ka fituar në postet e tij në fushën e zbulimit.

50. Sa i përket vizitës nën arrest të z. Veseli, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se vizita të tilla janë rrënjësisht të ndryshme nga lirimi i përkohshëm. Konkretisht, gjatë lirimimit të tij për një kohë të shkurtër nga Njësia e Paraburgimit të DHS-së u zbatuan një numër kushtesh të rrepta mbi bazën e arsyeve të forta humanitare për shkak të shëndetit të babait të tij, ndër të cilat: (i) transferimi në një objekt të sigurt paraburgimi në Kosovë; (ii) vazhdimi i mbajtjes nën arrest nga DHS-ja dhe përcjellja dhe qëndrimi nën vëzhgimin e oficerit apo oficerëve përcjellës gjatë tërë kohës; dhe (iii) moskontaktimi i personave të tjerë përveç anëtarëve të identifikuar të familjes dhe personelit mjekësor përkatës.⁹⁹ Duke pasur parasysh qëllimin konkret të lirimimit për një kohë të shkurtër të z. Veseli nga Njësia e Paraburgimit të DHS-së dhe nevojën për masa të rrepta, sjellja e tij dhe e familjes së tij nuk është vendimtare për qëllimet e këtij vendimi. Gjithashtu, më herët është konstatuar se marrëveshja e z. Veseli me ZPS-në për dorëzimin e tij vullnetar dhe deklarata e tij ku kërkon respektimin e DHS-në nuk anulojnë asnjë prej rreziqeve të identifikuara.¹⁰⁰

51. Rrjedhimisht, në kontekstin e rëndësisë së konstatimeve të bëra më lart lidhur me rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit si dhe të pamjaftueshmërisë së kushteve të propozuara dhe kushteve shtesë, tri konsideratat e paraqitura nga z. Veseli duhet të marrin rëndësi të kufizuar dhe ato përfundimisht nuk ndikojnë në vlerësimin e mëparshëm mbi lirimimin me kusht të tij. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se asnjë nga kushtet e propozuara dhe asnjë nga kushtet shtesë nuk do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit.

⁹⁹ KSC-BC-2020-06, F00271/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i redaktuar publik i vendimit në lidhje me kërkesën e mbrojtjes së Veselit për lirim të përkohshëm për arsye humanitare*, 30 prill 2021, para.

¹⁰⁰ Vendimi i parë për paraburgimin, para. 33, 39; Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 50.

D. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

52. Sipas parashtrimit të z. Veseli, ZPS-ja jo vetëm që po e kryen procesin e nxjerrjes së informacionit në mënyrë joefektive, por ajo gjithashtu ka caktuar afate të paarsyeshme që është vërtetuar se nuk mund t'i respektojë.¹⁰¹ Z. Veseli është i mendimit se ZPS-ja nuk do të jetë e gatshme për gjykim deri vonë vitin e ardhshëm.¹⁰²

53. ZPS-ja përgjigjet se sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte detyrimin të vlerësonte kohëzgjatjen e mundshme të paraburgimit në vendimin e parë për paraburgimin.¹⁰³ Ajo shton se të gjitha afatet në këtë çështje janë respektuar ose janë zgjatur për arsye të përligjura dhe nuk ka asnjë tregues se ZPS-ja ka ngadalësuar procesin.¹⁰⁴ Sipas ZPS-së, z. Veseli është në paraburgim që prej shtatë muajsh për një varg krimesh lufte dhe krimesh kundër njerëzimit të kryera gjatë një periudhe gati dyvjeçare dhe shkalla e këtyre akuzave ndikon në të gjitha aspektet e procesit gjyqësor.¹⁰⁵ Ajo gjithashtu është e mendimit se këmbëngulja e z. Veseli se procedura paraprake është tepër e gjatë nuk mban parasysh përgjegjësinë që ka ai vetë për këtë.¹⁰⁶

54. Z. Veseli kundërpërgjigjet se kërkesat e tij për ndryshimin e afateve u vlerësuan si të arsyeshme nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹⁰⁷ Gjithashtu, ai parashtron se pas përgjigjes, ZPS-ja parashtrroi një kërkesë tjetër për shtyrjen e afatit.¹⁰⁸

55. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Veseli u arrestua më 5 nëntor 2020; (ii) ai është akuzuar për një numër krimesh kundër njerëzimit dhe krime lufte në lidhje me ngjarjet që kanë të bëjnë me disa vendndodhje në Kosovë dhe Shqipëri gjatë një periudhe të gjatë kohore; (iii) nëse shpallet fajtor, ai mund të dënohet me

¹⁰¹ Kërkesa, para. 27.

¹⁰² Kërkesa, para. 29.

¹⁰³ Përgjigjja, para. 22.

¹⁰⁴ Përgjigjja, para. 22.

¹⁰⁵ Përgjigjja, para. 23.

¹⁰⁶ Përgjigjja, para. 24-25.

¹⁰⁷ Kundërpërgjigjja, para. 13-14.

¹⁰⁸ Kundërpërgjigjja, para. 15.

burgim të gjatë, përfshirë dënimin me burgim të përjetshëm; (iv) rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me kushtet e propozuara e as me kushte të tjera shtesë; (v) të gjithë hapat proceduralë në lidhje me fazën paraprake të kësaj çështjeje gjyqësore kanë përfunduar, po përfundojnë, ose do të përfundojnë, me synim kalimin e çështjes për gjykim në të ardhmen e parashikueshme; (vi) afatet kohore përkatëse ose janë respektuar, ose janë zgjatur për arsye të përligjura – në disa raste edhe me kërkesë të z. Veseli – dhe çdo kërkesë shtesë për zgjatjen e afateve do të vlerësohet sipas kriterëve ligjore përkatëse; dhe (vii) z. Veseli dhe ZPS-ja vazhdojnë të mos pajtohen për datën e mundshme të fillimit të gjykimit.

56. Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se koha që z. Veseli ka kaluar në paraburgim para gjykimit nuk është e paarsyeshme. Për të njëjtat arsye, lidhur me atë që z. Veseli argumenton se ZPS-ja po shkakton vonesa të paarsyeshme në kuptimin e rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se në këtë fazë çdo diskutim në lidhje me kohëzgjatjen e gjithsejtë të paraburgimit paraprak të z. Veseli është i parakohshëm dhe hamendësues.¹⁰⁹

VENDIM

57. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Veseli;
- b) **URDHËRON** z. Veseli që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit jo më vonë se **të enjten, më 12 gusht 2021**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores;
- c) **URDHËRON** ZPS-në që, nëse z. Veseli vendos të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, ajo mund të paraqesë parashtrime në lidhje

¹⁰⁹ Vendimi i Gjykatës së Apelit, para. 59.

